



**ELBASAN**  
Peqin  
Librazhd  
Belsh  
Cërrik  
Gramsh

## UKR Elbasan



# UKR Elbasan – 13.8 milionë euro masa investimi WPIP / MIP V



*Në Elbasan, investimi prej 13.8 milionë euro të programit WPIP / MIP V ofron rrjete të reja furnizimi me ujë, një sistem të ri dhe të përmirësuar të shpërndarjes së ujit dhe të monitorimit e kontrollit të konsumit, rezervuarë të rinj dhe të përmirësuar të ujit, si dhe një rrjet të ri ujërash të ndotura për mbrojtjen e burimeve të ujit të pijshëm.*

*Falë mbështetjes së Bashkëpunimit Financiar Gjerman përmes KfW-së, Bashkimit European, SECO-s dhe Qeverisë Shqiptare, përmes programit WPIP / MIP V, rreth 49,000 qytetarë si edhe numri gjithnjë në rritje i turistëve po përfitojnë nga kjo infrastrukturë e re dhe e përmirësuar.*



## Rehabilitimi dhe zgjerimi i rrjetit të ujit të pijshëm



- Mbi 43.8 km tubacione kryesore janë zëvendësuar dhe 2,600 lidhje të reja familjare janë instaluar.
- Rreth 7,300 matës të rinj individualë të ujit janë vendosur në Elbasan.



Prerja e asfaltit për përgatitjen e instalimit të rrjetit.



Matësit individualë të ujit për familjet janë thelbësorë për faturim të drejtë, transparent dhe të saktë të konsumit të ujit.



Tubacione të reja kryesore të shpërndarjes janë instaluar.



## Rezervuar i ri i ujit të pijshëm dhe rehabilitimi i plotë i rezervuarëve ekzistues



Ndërtimi i rezervuarit të ri të ujit në Krastë e Madhe, i cili do të mbajë 2,000 m<sup>3</sup> ujë të freskët dhe të pastër të pijshëm.



Punimet për instalimin e një pompe të re për rezervuarin e rehabilituar të Krastës së Madhe.




Paneli i kontrollit të rezervuarit të rehabilituar të Krastës së Madhe.


- Rezervuari i vjetër kryesor i Krastës së Madhe u shemb dhe u ndërtua një rezervuar krejt i ri kryesor në Krastë e Madhe, me kapacitet 2,000 m<sup>3</sup>.
- Të gjithë rezervuarët e tjerë ekzistues të Krastës së Madhe dhe Krastës së Vogël janë rehabilituar dhe modernizuar plotësisht dhe tani monitorohen dhe kontrollohen me ndihmën e sistemit të ri SCADA.




# Monitorim i kompjuterizuar për kontrollin e rrjetit të ujit dhe reduktimin e humbjeve të ujit



**DMA – “District Measuring Area”:** matës uji vendosen në tubat kryesore për të krahasuar konsumin e ujit të gjithë matësve familjarë të lidhur me sasinë e matur nga matësi i zonës përkatëse. Kjo ndihmon në identifikimin e rrjedhjeve të ujit dhe ose lidhjeve të paligjshme.




- Përmirësimi i sistemit DMA rrit kontrollin e rrjetit dhe redukton humbjet e ujit.
- Zbatimi i sistemit SCADA (“Supervisory Control and Data Acquisition”) mundëson monitorimin në kohë reale të të gjithë elementëve të rëndësishëm të sistemit të ujit të pijshëm të Elbasanit: monitorimin dhe kontrollin e rezervuarëve, fushave të puseve dhe rrjeteve të shpërndarjes së ujit.
- Çdo problem identifikohet menjëherë nga sensorët e debitit dhe presionit dhe shfaqet në ekranin e kompjuterit.



## Mbrojtja e fushave të puseve


- Ndërtimi i një rrjeti të ujërave të ndotura prej 3.4 km që shërben për të mbrojtur fushat e puseve të Krastë e Vogël, Mengel dhe Frigoriferi.



Punime në ndërtimin e sistemit të ri të kanalizimeve për mbrojtjen e puseve të ujit të pijshëm.

## WPIP / MIP V në total – masa e investimit prej 145.7 milionë eurosh për 6 shoqëri rajonale të ujësjellës-kanalizimeve

Programi WPIP / MIP V mbështet 6 shoqëri rajonale të ujësjellës-kanalizimeve





- **UKR Berat** që përfshin Dimalin, Kuçovën, Poliçanin dhe Skraparin
- **UKR Elbasan** që përfshin Belshin, Cërrikun, Gramshin, Librazhdin dhe Peqinin
- **UKR Fier** që përfshin Mallakastrën, Patosin dhe Roskovecin
- **UKR Lezhë** që përfshin Kurbinin dhe Mirditën
- **UKR Shkodër** që përfshin Fushë-Arrëzin, Malësinë e Madhe, Pukën dhe Vau i Dejës
- **UKR Vlorë** që përfshin Himarën dhe Selenicën

Rezultatet dhe përfitimet e pritura nga WPIP / MIP V

Bashkëpunimi Financiar Gjerman përmes KfW	Hua	80 milionë EURO
Qeveria Gjermane	Grant	9 milionë EURO
EU IPA	Grant	43.4 milionë EURO
SECO	Grant	13.3 milionë EURO

## Rezultatet dhe përfitimet e pritura nga WPIP / MIP V



100% mbulim i **Kostove Operative Direkte;**  
Ulja e humbjeve të ujit;  
Plane tarifore të përshtatura;  
Përmirësim i faturimit,  
norma e mbledhjes mbi  
85% në mënyrë të vazhdueshme;  
Përmirësim i verifikuar i **qeverisjes së mirë;**

Rritja e **sistemit mbrojtës nga reshjet e shiut** për 30,000 persona në Lezhë

152,000 banorë të lidhur në mënyrë efektive me rrjetin operativ të mbledhjes së **ujërave të ndotura me sisteme të centralizuara trajtimi,** të monitoruara sipas direktivave të BE-së

**Rritje në mënyrë efektive të lidhjeve në rrjetin e ri** ose ekzistues të ujit të pijshëm.  
Rritje e mesatares së orëve të **furnizimit me ujë nga 13 në 16 orë në ditë.**

